

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	207-24-8996-5-1-1
Nr i brendshëm	207-24-079-5-1-1

Sa i përket tenderit për: "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i Pepa Group & Conex L.L.C & Agri Construction sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bulevardi Bill Klinton, nr 9

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+35569800202

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lulzim Pepa

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@pepagroup.al

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



(Adresa elektronike)

01.04.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 02.09.2024
Data e hapjes së ofertave: 02.12.2024
Njoftimi mbi vendimin: 13.03.2025
Kërkesa për rishqyrtim dt. 17.03.2025



4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e metutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së



Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për Kontratë në lidhje me këtë tender është publikuar me dt.02.09.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt.02.12.2024

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publiku me dt.13.03.2025, ku është rekomanduar për kontratë OE BM Group SH.P.K, ndërsa ne jemi eliminuar me një arsyetimin shumë të pa bazuar dhe të paqëndrueshëm

Arsyeja e eliminimit është dhënë në këtë mënyrë:

Grup i Operatorëve Ekonomik Pepa Group; CONEX L.L.C.; Agri Construction shpk: nuk plotëson kriterin për referenca mbi 15,000,000.00 Euro pasi që të njëjtit bazuar në Dokumentacionin e bashkangjitur kanë paraqitur listën (sipas aneksit 1) në vlerë financiare 19309660.04 Euro mirëpo që projekti në vlerë financiare 3921776.29 dhe projekti në vlerë financiare 886859.75 Euro janë realizuar ose kanë pranim në Tetor 2024 ndërsa procedura është hapur me datë 29.08.2024 dy muaj para këtij pranimi. Dihet se përmes LPP dhe Rregullores (Referencat kanë të bëjnë me datën para publikimit të Njoftimit për Kontratë). Shtoja kësaj GOE nuk e arrijnë 60% e vlerës së Liderit pasi që 60% e vlerës 15 milionë është 9 milionë euro ndërsa kompania ka vetëm 8.98 milionë Euro.

Sa i përket kërkesës për kontrata dhe referenca në vlerën e kërkuar prej 15,000,000.00€, sqarojmë se ne jo vetëm që e plotësojmë këtë kërkesë por e tejkalojmë shumë më shumë.

Sa i përket kontratave të kontestuar sqarojmë se këto dy kontrata janë të përfunduara para datës së njoftimit për kontratë dhe kjo dëshmohet dy kontratat janë të përfunduara me dt.30.07.2024.

Dokumenti i bashkangjitur me ofertë ka përmbajt një lëshim teknik sa i përket datave, pasi që të dy këto kontrata janë përfunduar para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, pra me dt.30.07.2024. **Sa për korrektësi po ua bashkangjesim dëshmitë e tilla që konfirmojnë pretendimin tonë ankimor.**



Dëshmia e ofruar fillimisht nga lideri ka një lëshim teknik, mirëpo ne po ua sqarojmë se kontrata me Daed është përfunduar me dt.30.07.2024 ndërsa fatura e fundit në lidhje me këtë kontratë është lëshuar me dt.31.08.2024 dhe kjo dëshmohet nga faturat të cilat po ua bashkangjesim si dëshmi.

Po ashtu edhe kontrata tjetër ku vetë Pepa Group ka qenë ndërtues dhe financues është përfunduar me dt.30.07.2024 dhe fatura e fundit është lëshuar me dt.31.08.2024. Po ua bashkangjesim faturat si dëshmi të realizimit dhe të përfundimit të kontratave përkatëse.

Me këto dëshmi vërtetohet se është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit për kontrata të natyrës së kërkuar e po ashtu edhe kërkesa që lideri të ketë paku 60 % të punëve të përfunduara.

Bazuar në këto dëshmi konsiderojmë së mjaftueshëm dhe bindshëm vërtetohet fakti se grupi jonë ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional përkitazi me kontratat dhe referenca në vlerën e kërkuar, andaj konsiderojmë se jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit.

Nëse ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me kontratat dhe dëshmitë atëherë është dashur të kërkohej sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së e jo të eliminohemi pa e konsumuar mundësinë e sqarimeve shtesë. Sidomos kur kem parasysh faktin se ne jemi ofertues me çmim më të lirë.

Neni 7 i LPP-së përcakton qartë se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar këtë dispozitë të LPP-së. Gjithashtu me veprimet e AK-së nuk është respektuar edhe neni 59 - **Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, sepse nuk është vlerësuar oferta e jonë në mënyrë të drejtë dhe ligjore.**

Ne si grup i OE kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa qasja na është lejuar shumë e kufizuar apo më mirë të themi nuk na është lejuar fare sepse asnjë dokument me rëndësi nuk na është dhënë.

Plotësimi i aneksit 3 të dosjes së tenderit nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është keqkuptuar dhe keqinterpretuar nga ana e autoritetit kontraktues sepse nuk mund të pranohet që tërë dokumentacioni të mbetet dhe pranohet sekret afarist.

Veprimet e autoritetit kontraktues përbëjnë shkelje ligjore të nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Për tu konsideruar sekret afarist një dokument duhet të arsyetohet se si mund ta dëmtojë kompaninë zbulimi i këtij dokumenti, kurse në rastin konkret nuk ka të dhënë asnjë arsyetim OE i rekomanduar për kontratë se si mund të dëmtohen interesat e tij nëse zbulohen dokumentet siç janë kontrata dhe dëshmitë e tjera.

Në mungesë të informacioneve dhe dëshmive për ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, neve detyrimisht jemi të obliguar të parashtrojmë pretendime ankimore mbi bazën e dilemave dhe dyshimeve.

Kërkesat të cilat dyshojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson janë:



Kërkesa tek neni 6.4 i fletës së të dhënave të tenderit:

Kërkesa numër 1 Deklarata nën betim se operatori ekonomik i përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë sipas LPP nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 – forma Aneksi 2, dosja e tenderit. **Kërkesa numër 2** Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit -vetëm për fituesin. **Kërkesa numër 3** Vërtetimin nga Gjykata- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- te jete i lëshuar se paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit, origjinal kopje e noterizuar - vetëm për fituesin.

Dëshmitë për kërkesën nr.1 Deklaratë nën betim - e plotësuar, e nënshkruar dhe e vulosur. **Dëshmitë për kërkesën nr.2.** Një vërtetim nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin. **Dëshmitë për kërkesën nr.3** Vërtetimin nga Gjykata - origjinal ose kopje e noterizuar- vetëm për fituesin.

Për këtë kërkesë konsiderojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka borxhe në ATK dhe nëse eventualisht ka marrëveshje për borxhe atëherë duhet të analizohet se me çfarë date është bërë marrëveshja për borxh.

Kërkesa tek neni 8.1&8.2 i fletës së të dhënave të tenderit:

Kërkesa 1.1. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe të kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojnë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, në shumën prej 20,000,000.00 € [Njëzet milion euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.1. Raportet financiare dhe raportet e menaxhimit për secilin nga tre [3] vitet fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi (‘leader’) i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] Një [1] kopje e origjinalit.

Dyshojmë se i njëjti OE nuk ka mjete në bankë në vlerën e kërkuar e po ashtu nuk ka ofruar vërtetim nga banka për qasje të pakushtëzuar në kredi

Kërkesa tek neni 9.1&9.2 i fletës së të dhënave të tenderit:

Kërkesa 1.2. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qofte mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi bankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti,



përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro].

Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2. Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] Një [1] kopje e origjinalit. OSE Një [1] vërtetim nga një Bankë e kasës së parë, i cili dëshmon se Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik, disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumën 2,000,000.00 € [Dy milion euro]. [Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik, udhëheqësi ('leader') i Grupit, duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] Një [1] kopje e origjinalit.

Dyshojmë se nuk ka kontrata dhe **referenca në vlerën e kërkuar**. Dyshojmë se nuk ka kontrata të **natyrës së kërkuar**, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Kërkojmë nga OSHP-ja-së që të verifikojë dokumentet të cilat po i kontestojmë.

Autoriteti kontraktues me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim ka dal jashtë pretendimeve ankimore duke u marr edhe me referenca të tjera kinse nuk i plotësojnë kërkesat e dosje së tenderit, e që ky veprim është joligjor dhe tendencioz, pasi që në këtë rast është dashur të merren vetëm me pretendimet ankimore.

Autoriteti kontraktues sa i përket kontratës me Pepa Group SHPK ka pretenduar se është përmbyllur në tetor të vitit 2024, kinse pas hapjes së procedurës, mirëpo publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me dt.02.09.2024 kurse përfundimi i kontratës është bërë me dt.30.07.2024, andaj ky pretendim i AK-së është i pabazuar.

Të njëjtin pretendim e ka paraqitur edhe për kontratën me Dead Shpk, mirëpo edhe kjo kontratë është përfunduar me dt.30.07.2024, andaj edhe ky pretendim është i pabazuar dhe është arsye e eliminimit jo e argumentuar.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar me seriozitet, ku për pretendimin ankimor se operatori i shpërblyer me kontratë ka borxhe në ATK vetëm ka konstatuar se kjo kompani ka paraqitur një dokument të ATK-së të dt.06.02.2025, i cili është i vlefshëm. Pra autoriteti kontraktues me vet faktin se nuk është përgjigj drejtpërdrejtë në këtë çështje na bënë të dyshojmë edhe më shumë se OE i shpërblyer me kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë, me siguri duke mos e pasur marrëveshjen për shlyerjen e borxheve para njoftimit për kontratë.

Në lidhje me qarkullimin financiar të OE të shpërblyer me kontratë, autoriteti kontraktues vetëm ka konstatuar se për 50 % e tejkalon shumën e kërkuar, mirëpo nuk ka ofruar ndonjë dëshmi por këtë konstatim, andaj për neve është i pabesueshëm ky konstatim.

E njëjta përgjigje është edhe për pretendimin tonë ankimor se OE i shpërblyer me kontratë nuk ka ofruar dëshmi për qasjen në kredi, ku autoriteti kontraktues vetëm e ka cekur se i njëjti OE ka të aprovuar 4.4 milion euro por që nuk ka ofruar asnjë dëshmi.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE i shpërblyer me kontratë nuk ka përmbushur kërkesën për kontrata dhe referenca, autoriteti kontraktues ka sqaruar se këto janë plotësuar



përmes nenit 72 dhe 59 të LPP-së kinse ka ofruar dëshmi të pranimit teknik, kontrata, referenca, ndërsa me OE privat ka ofruar faturat e nënshkruara si dhe konfirmime apo transaksione të pagesave, mirëpo nuk janë ofruar asnjë dëshmi për këto, gjë që e bënë të pabesueshëm konstatimin e tyre.

Me këtë rast kemi mos respektim edhe të kriterit kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së.

Grupi i jonë ofertues ka ofertuar me çmim prej 12,282,015.00 €, kurse OE i rekomanduar për kontratë 12,783,110.01€, e që do të thotë se ne kemi ofertuar me çmim më të lirë në vlerë prej 501,095.01€.

Me këtë veprim të autoritetit kontraktues rrezikohet të dëmtohet buxheti në vlerë prej **gjysmë milioni euro**, ndërsa me këtë vlerë mund të përfundohet edhe një projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Me këtë veprim është cenuar parimi i efikasitetit që parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu AK-së nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e GOE *Pepa Group & Conex L.L.C & Agri Construction sh.p.k*

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.



v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*



Per: Organi Shqyrtues i Prokurimit

Tema: Të nder bashkangjitur keni ankesën në lidhje me tenderin "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit ne Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA"

Nr ¹ i prokurimit	207-24-8996-5-1-1
Nr i brendshëm	207-24-079-5-1-1

Nga: PEPA GROUP SH.P.K, CONEX L.L.C, AGRI CONSTRUCTION SH.P.K

AUTORIZIM

Autorizojm bashkantarin e konzorciumit "CONEX" L.L.C, qe te paraqes ankesen prane Organit Shqyrtues te Prokurimit per aktivitetin e prokurimit: Të nder bashkangjitur keni ankesën në lidhje me tenderin "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen [ri-konfigurimin] e Stadiumit ne Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadiumeve, të miratuara nga UEFA"

Nr i prokurimit 207-24-8996-5-1-1 Nr i brendshëm 207-24-079-5-1-1

Agri Construction sh.p.k



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

CONEX L.L.C., Prishtinë, Rruga Major Mehmet Bushi, Hyr.9/4-1, 30100 Prishtinë

Përshkrimi
Opis
Description

Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të
rregullimit hapësinor, të arkitekturës dhe inxhinierisë, për rindërtimin dhe përshtatjen
[ri-konfigurimin] e Stadiumit në Gjilan, në përputhje me Kategorinë IV të rregulloreve
dhe udhëzimeve teknike për infrastrukturë të stadioneve, të miratuara nga UEFA.

Shuma / Iznos
Amount

€ 207-24-8996-5-1-1 Euro Ct Data / Datum / Date

Me fjalë / Rečima
In words

1 0 0 0 0 0 0

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.